



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHDI
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Veprimtarisë Ekonomike, Financiare, Buxhetit, Pronës dhe i Zënies me Punë

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr.1 datë 30/03/2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit **“PER MIRATIMIN E TAVANEVE PERGATITORE PER PROJEKT-BUXHETIN AFATMESEM 2027-2029”**.

Analiza ligjore: Projekt-vendimi është i mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” Udhëzimit nr.07 datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”.

Situata aktuale e funksionit Propozimi dhe miratimi i këtij vendimi është kërkesë e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe si e tillë ai vjen në kohën e duhur në zbatim të ligjit, Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Situata financiare : Projekti prezanton përdorimin efikas të fondeve publike në sektorë kyçë ,duke garantuar qëndrueshmëri fiskale dhe mbështetje për rritjen ekonomike për një periudhë 3 vjeçare 2027- 2029 .

Drejtoria / Sektori përgjegjës – Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Çeshtjeve Sociale .

Monitorimi dhe raportimi : Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Çeshtjeve Sociale monitoron dhe shpërndan fondet sipas nevojave të bashkisë.

Impakti social / grupet që preken: Miratimi i tavaneve përgatitore ka ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien sociale, zhvillimin ekonomik dhe barazinë sociale. Përmes këtij projekt raporti përcaktohen prioritetet e qeverisë dhe mënyra e shpërndarjes së burimeve publike.

A është objekt i konsultimit publik: Projekt-vendimi është objekt i konsultimit publik .


“ Komisioni i Përhershëm i Veprimtarisë Ekonomike, Financiare, Buxhetit, Pronës dhe i Zënies me Punë ” , i mbledhur me datën ___/ 03 //2026 shqyrtoi projekt vendimit “Për miratimin e tavaneve përgatitore per projekt-buxhetin afatmesem 2027-2029”, relacionin dhe dokumentat shoqërues paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak: **Miratimin e projektaktit**

Bashkëlidhur procesverbali i mbledhjes së Komisionit

Adriciu Doda  Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Lenel Bahiti  Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë 30/03/ 2026